



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë

Numër 18

M A J 2 0 2 4

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë dhe Pritjet për Inflacionin

(TM4 2023 dhe pritjet për TM1 2024)

Numër 18

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

Faqja e internetitwww.bqk-kos.org**Adresa elektronike**

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK) -----	4
Hyrje -----	4
Përmbledhja e rezultateve -----	4
Kutia 1. Metodologjia -----	7
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi -----	8
Kreditë ndaj ndërmarrjeve -----	8
Standardet kreditore -----	8
Kushtet dhe rregullat-----	9
Kërkesa për kredi-----	9
Kreditë ndaj ekonomive familjare -----	10
Standardet kreditore -----	10
Kushtet dhe rregullat-----	11
Kërkesa për kredi-----	12
Financimi -----	13
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara -----	14
Pritjet për Inflacionin -----	15
Metodologjia -----	15
Përmbledhja e rezultateve -----	15

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi, do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2023, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e parë të vitit 2024.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me katër pyetje shtesë në përpjekje për të identifikuar rreziqet eminente në sektorin bankar, si dhe zbrërthimin e ofertës dhe kërkesës kreditore për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik.

Përmbledhja e rezultateve²

Stoku i kredive vazhdoi me rritje deri në tremujorin e katërt të vitit 2023, mirëpo me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kreditë e reja krahasuar me tremujorin e njëjtë të një viti më parë shënuan rritje më të lartë, përderisa krahasuar me tremujorin paraprak, shënuan rritje më të ngadalësuar. Kjo dinamikë kryesisht reflektoi qasje më të kujdesshme të konsumatorëve në ndërmarrjen e borxheve shtesë në ambient të rritjes së kostos së jetesës dhe pasigurive më të larta, por edhe qasje dhe monitorim më të kujdesshëm të bankave në kredi-dhënie përgjatë vitit 2023. Këto zhvillime janë gjithashtu në linjë me qasjen e politikës shtrënguese monetare si kundërpërgjigje ndaj presioneve inflacioniste. Dinamikat në aktivitetin kreditor u ndikuan në masë më të madhe nga kërkesa kreditore, pasi që oferta kreditore kishte ndryshime marginale negative gjatë këtij tremujori. Për tremujorin e ardhshëm, bankat presin që shtytësi i aktivitetit kreditor të vazhdoj të jetë kërkesa kreditore, përderisa oferta kreditore pritet të ketë ndryshime marginale pozitive.

Sipas bankave, dinamika e kreditimit të ndërmarrjeve gjatë këtij tremujori u ndikua nga kërkesa kreditore, që shënoi rritje deri në një masë, përderisa oferta kreditore nga bankat për këtë segment kishte ndryshime marginale negative (shtrëngim të lehtë). Në kuadër të kategorive të ndërmarrjeve, bankat deklaruan se do të aplikojnë standarde kreditore me lëvizje marginale negative (shtrëngim të lehtë), si për ndërmarrjet e mëdha ashtu dhe për NVM-të (tabela 1). Në kontekst të faktorëve që i ndikuan këto zhvillime, rritja e normës së EURIBOR dhe perspektiva jo e mirë në tregjet globale rezultojnë të kenë qenë kontribuuesit kryesor negativ në standardet kreditore (shtrëngim deri në një masë). Në anën tjetër, mbështetja nga FKGK kishte ndikim pozitiv në standardet kreditore (lehtësim deri në një masë). Faktorët tjerë që ndikuan në standardet kreditore kishin lëvizje marginale të ulët pozitive/negative dhe kryesisht kanë të bëjnë me perceptimin e rrezikut, koston e financimit dhe kufizimeve në bilancin e gjendjes, cilësinë e portfolios kreditore, presionin nga konkurrenca dhe tolerancën ndaj rrezikut. Për tremujorin e parë të vitit 2024, pritjet e bankave për aktivitetin

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

² Pyetësori dhe seria kohore e rezultateve të AKBK-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

kreditues konsistojnë të jenë të ngjashme me zhvillimet në tremujorin e fundit të vitit 2023, me lëvizje marginale negative (shtrëngim të lehtë) në standardet kreditore të aplikuara nga bankat si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha (tabela 1). FKGK pritet të ketë efekt lehtësues, ndërkohë që pasiguritë rreth dinamikave në normat e financimit (EURIBOR) dhe kapaciteti për ngritje të fondeve (rritje të depozitave) mund të kenë potencial shtrëngues.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet në përgjithësi mbetën kryesisht të pandryshuara (brenda limitit $+0.05/-0.05$) për të dy segmentet e ndërmarrjeve. Mirëpo, tek segmenti i NVM-ve u aplikua lehtësim i standardeve deri në një masë në normën e interesit të aplikuar, si dhe lehtësim marginal në kërkesën për kolateral. Tek ndërmarrjet e mëdha, rezultojnë të ketë pasur shtrëngim marginal në normën e interesit të aplikuar, si dhe në kërkesën për kolateral. Për të dy segmentet, rezultatet e agreguara sugjerojnë të ketë pasur shtrëngim marginal sa i përket maturitetit të kredive. Kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan negativisht nga rritja e normës së EURIBOR-it dhe perspektiva jo e favorshme në tregjet globale. Në anën tjetër, mbështetja nga FKGK ndikoi pozitivisht në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet (lehtësim). Në tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të mbeten të pandryshuara (brenda limiteve $+0.05/-0.05$). Si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha, norma e aplikuar e interesit nuk pritet të ndryshojë, kurse shtrëngim marginal pritet të ketë në kërkesat për kolateral dhe maturitet të kredive. Perspektiva jo e mirë në tregjet globale si dhe cilësia e portfolios kreditore pritet të ndikojnë negativisht pritjet e bankave mbi kushtet dhe rregullat gjatë tremujorit të ardhshëm, e të cilat priten të neutralizohen nga mbështetja e FKGK-së në garantimin e kredive.

Në tremujorin e katërt të vitit 2023, në përgjithësi kishte rritje deri në një masë të kërkesës për kredi bankare nga ndërmarrjet, e që përbën ndryshim krahasuar me dinamikën e tremujorit paraprak (rënie deri në një masë). Kërkesa për kredi rezultojnë të ketë qenë më e lartë nga NVM-të (rritje deri në një masë), kundrejt kërkesës për kredi ndërmarrjet e mëdha (rritje marginale). Në përgjithësi, rritja e kërkesës për kredi, sipas deklarimeve të bankave, u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financim të inventarit dhe kapitalit punues, e që u neutralizua deri në një masë nga rënia marginale e kërkesës për investime fikse. Indeksi i gjeneruar për pritjet e bankave mbi kërkesën kreditore gjatë tremujorit të ardhshëm tregon rritje më të lartë të kërkesës për kredi nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Këto pritje bankat i'a atribuon rritjes së pritur të kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues dhe investimeve fikse, në pajtim me ciklin e biznesit.

Stoku i kredive të ekonomive familjare deri në tremujorin e katërt të vitit 2023 shënoi rritje të përafërt vjetore krahasuar me vitin paraprak. Në baza vjetore, kreditë e reja rezultojnë të kenë shënuar rritje të theksuar në TM4 2023, ndërkaq në baza tremujore, rritje dukshëm më të ngadalësuar. Aktiviteti u mbështet nga rritja e kërkesës për kredi, ndërkohë që oferta kreditore në përgjithësi rezultojnë të ketë qenë e pandryshuar. Standardet kreditore u lehtësuan deri në një masë për kreditë për blerjen e shtëpive, ndërsa ato u shtrënguan deri në një masë për kreditë konsumuese përgjatë tremujorit të katërt të vitit 2023. Presioni nga konkurrenca dhe cilësia e portfolios kreditore ishin dy faktorë që ndikuan në lehtësim të standardeve kreditore për ekonomitë familjare, ndërkohë që rritja potenciale e kostos së financimit ndikoi negativisht dinamikat.






Në tremujorin e parë të vitit 2024, bankat në përgjithësi presin ndryshime marginale pozitive në standardet kreditore. Bankat presin lehtësim deri në një masë për kreditë që kanë për qëllim blerjen e patundshmërive, kurse për kreditë me qëllim konsumi, standardet pritet të lehtësohen në nivele marginale (tabela 1). Faktorët që priten të ndikojnë pozitivisht në standardet kreditore (lehtësim) janë perspektiva e bankave vendore/tregut vendor, ecuria e tregut të patundshmërive si dhe besueshmëria ndaj kredi-marrësve. Kurse, faktorët që pritet të neutralizojnë lehtësimin në standardet kreditore (shtrëngim) janë cilësia e portfolios kreditore, norma e EURIBOR-it dhe toleranca ndaj rrezikut.

Në përgjithësi, kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u shtrënguan në nivele marginale gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023. Rezultatet e gjeneruara reflektojnë shtrëngime proporcionale si për kreditë për blerje të shtëpive edhe ato konsumuese, përmes rritjes së normës së interesit. Faktori kryesor në rritjen e normës së interesit ishte rritja e normës së EURIBOR-it, ndërkohë që përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore dhe presioni nga konkurrenca ishin faktorët me ndikimin më të lartë pozitiv (lehtësim) në kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e ekonomive familjare. Për tremujorin e parë të vitit 2024, bankat në përgjithësi presin lëvizje të marginale pozitive (lehtësim) në kushteve dhe rregullave për kreditë e ekonomive familjare, përfshirë rritjen e maturitetit të kredisë për blerje të shtëpive dhe ulje të kërkesave të kolateralit për kreditë me qëllim konsumi.

Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare ka shënuar rritje gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, me kërkesën për kredi konsumuese që rezultojnë të ketë qenë shumë më e lartë kundrejt asaj për blerje të shtëpive. Sipas bankave, nevoja për financim të shpenzimeve të konsumit dhe rritja e besueshmërisë së konsumatorëve kontribuuan në rritje të kërkesës për kreditë konsumuese, ndërkohë që perspektiva pozitive në tregun e patundshmërive ka ndikuar në rritje të kërkesës për kredi për blerje të patundshmërive. Në tremujorin e parë të vitit 2024, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare në një nivel të përafërt me atë nivelin aktual (tabela 1). Kërkesa për kredi në përgjithësi pritet të nxitet kryesisht nga kërkesa për kreditë konsumuese, që kanë peshën më të madhe në gjithsej kreditë ndaj segmentit të ekonomive familjare. Mirëpo, rritje të lartë të kërkesës pritet të ketë edhe për kreditë për blerje të shtëpive, mbështetur nga perspektiva e mirë në tregun e patundshmërive.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM4 2023	TM1 2024 (pritjet)	TM4 2023	TM1 2024 (pritjet)
Ndërmarrjet	→	→	↗	↗
NVM	→	→	↗	↗
Ndërmarrjet e mëdha	→	→	→	↗
Ekonomitë familjare	→	→	↗	↗
Kredi për blerjen e shtëpive	↗	↗	↗	→
Kredi konsumuese	↘	→	↗	↑

 Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
 Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)
 Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
 Shtrëngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)
 Shtrëngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)

Burimi: BQK.

Monitorimi i kujdesshëm i performancës financiare të klientëve dhe vlerësimi më konservativ i aplikacioneve të reja për kredi nga bankat ka ndihmuar në mirëmbajtjen e nivelit të kënaqshëm të performancës së ri-pagimit të kredive. Bankat për tremujorin e katërt të vitit 2023 ishin më të moderuara në vlerësimin e aplikacioneve të reja, veçanërisht për ndërmarrjet e mëdha dhe kreditë konsumuese për ekonomitë familjare. Lehtësim në shqyrtim të aplikacioneve të reja kishte për kreditë me maturitet afatshkurtër, kurse për kreditë me maturitet afatgjatë bankat ishin më konservative për të dy segmentet (ndërmarrje dhe ekonomi familjare). Në tremujorin e parë (TM1 2024), niveli i vlerësimit të aplikacioneve të reja për kredi për ndërmarrje nuk pritej të ketë ndryshime të theksuara

krahasuar me tremujorin paraprak, kurse për ekonominë familjare, bankat pritjet t'i lehtësojnë standardet në aplikimet e reja, me theks të veçantë për kreditë konsumuese.

Bankat raportuan rritje të konsiderueshme të qasjes në financim gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023. Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u bazua në përgjigjet e nëntë bankave (prej tyre pesë banka me rëndësi sistemike) të cilat deklaruan rritje të financimit. Depozitat e ekonomive familjare kishin rritjen më të madhe, përderisa edhe financimi nga ndërmarrjet shënoi rritje, por në nivel më të ulët. Financimi nga bankat amë mbeti i pandryshuar, kurse financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare kishte kontribut marginal negativ pozicionin e përgjithshëm. Sipas maturitetit, rritje të theksuar shënoi financimi afatshkurtër, përderisa ai afatgjatë rritje më të ngadalësuar. Gjatë tremujorit të ardhshëm, disa banka presin rritje më të ngadalësuar të qasjes në financim, dinamikë që pritjet të ndikohet nga pritjet për ngadalësim të depozitave prej ekonomive familjare. Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin që rritja e financimit të jetë kryesisht nga financimi afatgjatë, përderisa ai afatshkurtër do të ketë kontribut marginal negativ në financim.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë

Pyetësi i AKBK është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKBK është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrë më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKBK përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritjet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKBK mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga dymbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithësej sektorit bankar dhe 99.1 përqind të gjithësej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithësej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë. Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori

bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.


Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

Kreditë ndaj ndërmarrjeve

Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, rezultati për standardet kreditore (politikat kreditore) të aplikuara për ndërmarrjet në përgjithësi nuk tregojnë lëvizje të rëndësishme. Pritjet e bankave të shprehura në anketën e kaluar (TM3 2023) për standardet kreditore të aplikuara ndaj ndërmarrjeve ishin më të lehtësuara, mirëpo në anketën e tanishme (TM4 2023) rezultojnë të jenë më të shtrënguara deri në një masë (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuon




Në kuadër të kategorive të ndërmarrjeve, bankat deklaruan standarde kreditore të shtrënguara marginalisht për ndërmarrjet e mëdha dhe NVM-të me indeks negativ prej 0.01 për secilën kategori. Faktorët kryesor që ndikuan negativisht standardet kreditore ishin rritja e normës së EURIBOR dhe perspektiva jo e mirë në tregjet globale me një indeks negativ 0.14 dhe 0.11, respektivisht. Përderisa, faktorët që deri në një masë ndikuan pozitivisht standardet kreditore (lehtësim), duke i ofruar siguri sektorit bankar, ishin mbështetja nga FKGK dhe zvogëlimi i rrezikut për kolateral të kërkuar me indeks pozitiv 0.11 dhe 0.04, respektivisht. Ndërsa, norma e aprovimit të kredive pritet të ketë rritje deri në një masë kryesisht për kreditë për ndërmarrjet e mëdha.

Standardet kreditore në përgjithësi pritet të kenë lëvizje marginale negative (shtrëngim) në tremujorin e ardhshëm, ngjashëm me tremujorin paraparak. Konkretisht, nëntë nga gjithsej dhjetë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan se nuk presin ndryshime në standardet kreditore për ndërmarrjet. Mbështetja nga FKGK pritet të kontribuoj pozitivisht standardet kreditore, përderisa rritja e normës së EURIBOR dhe perspektiva në tregjet globale pritet të kontribuojnë negativisht të njëjtat. Norma e aprovimit të kredive pritet të ketë rritje deri në një masë kryesisht për kreditë për NVM-të.

Kushtet dhe rregullat

Në tremujorin e katërt të vitit 2023, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet e specifikuar për një kontratë të caktuar për kredi) mbetën të pandryshuara për të dy kategoritë e ndërmarrjeve (brenda limitit +0.05/-0.05) (grafiku 2). Konkretisht, lehtësim deri në një masë u aplikua në normën e interesit të aplikuar për NVM-të me indeks pozitiv prej 0.07, kurse për ndërmarrjet e mëdha shtrëngim marginal prej 0.03. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e katër bankave, një prej tyre me rëndësi sistematike në sektor. Në anën tjetër, kërkesat për kolateral për NVM-të në përgjithësi rezultojnë të jenë zbutur me indeks pozitiv prej 0.05, e shprehur nga një bankë me rëndësi sistematike. Kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan negativisht nga rritja e normës së EURIBOR dhe perspektiva jo e favorshme në tregjet globale. Në anën tjetër, mbështetja nga FKGK-së dhe zbutja e rrezikut të kthimit të kolateralit të kërkuar ndikuan pozitivisht në kushtet dhe rregullat e aplikuara.

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Gjatë tremujorit të ardhshëm, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të kenë lëvizje marginale në të dy kahjet. Saktësisht, pritet shtrëngim në nivel marginal sa i përket maturitetit të kredive dhe kërkesave për kolateral tek NVM-të. Për ndërmarrjet e mëdha, lehtësim në nivele marginale të madhësisë së kredisë mesatare, kurse sa i përket maturitetit të kredive, ngjashëm me zhvillimet në NVM-të. Këto pritje u ndikuan pozitivisht nga mbështetja e FKGK dhe presioni i konkurrencës në mes të bankave, ndërsa rritja e normës së EURIBOR dhe perspektiva jo e favorshme në tregjet globale do të ndikojnë negativisht pritjet e bankave mbi kushtet dhe rregullat gjatë tremujorit të ardhshëm.


Kërkesa për kredi

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, kërkesa për kredi prej ndërmarrjeve shënoi rritje për dallim nga dinamika e tremujorit paraprak, ku kishte rënie deri në një masë të kërkesës për kredi. Saktësisht, përgjigjet gjeneruan indeks pozitiv prej 0.17, e shprehur nga gjashtë prej gjithsej dhjetë bankave pjesëmarrëse në anketë, ku prej tyre, dy banka me rëndësi sistematike dhe katër banka tjera me rëndësi josistematike deklaruan rritje të kërkesës për kredi. Gjithashtu, kërkesa për kredi rezultoi të jetë e ngjashme me pritjet e bankave për TM4 2023 të shprehura në anketën e kaluar (TM3 2023) (grafiku 3).

Sipas rezultateve të anketës, ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet u ndikuan kryesisht nga rritja e kërkesës për inventar dhe kapital punues prej 0.12. Bankat deklaruan rezultate pozitive ose të pandryshuara sa i përket rritjes së kërkesës për inventar dhe kapital punues, me theks të veçantë nga bankat me rëndësi josistematike. Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet kishte ndryshime marginale pozitive, pra përmirësim të aplikacioneve përgjatë TM4 2023.

Sipas anketës, gjatë TM4 2023 raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve u zvogëluar duke rezultuar me indeks negativ 0.16, e që rezultoi në këtë ndërruar kahje krahasuar me rezultatin në anketën e kaluar ku përgjigjet e bankave gjeneruan indeks pozitiv 0.13 të këtij raporti. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e katër bankave, ku prej tyre dy banka (dy me rëndësi sistematike) deklaruan rënie të raportit të kredive jo-performuese përderisa tri banka tjera me rëndësi sistematike deklaruan që niveli i kredive jo-performuese ishte i pandryshuar.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuon



Ngjashëm me tremujorin aktual, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet gjatë tremujorit të ardhshëm. Konkretisht, ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e gjashtë bankave (dy me rëndësi sistematike) të cilat deklaruan se presin rritje të kërkesës për kredi si për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha. Këto pritje bankat ia atribuon kryesisht rritjes së kërkesës për financimin e investimeve fikse si dhe inventarëve dhe kapitalit punues. Cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi pritet të ketë ndryshime marginale pozitive për NVM-të dhe ndryshime deri në një masë pozitive për ndërmarrjet e mëdha.

Gjatë tremujorit të ardhshëm bankat presin që raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet, të rritet në nivele marginale, me indeks pozitiv 0.08. Tri banka, ku një prej tyre me rëndësi sistematike, presin rritje të raportit të kredive jo-performuese të ndërmarrjeve, përderisa bankat tjera presin që ky raport të mbetet kryesisht i pandryshuar.

Kreditë ndaj ekonomive familjare


Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023 përgjithësisht mbetën të pandryshuara. Lehtësim deri në një masë u aplikua për kreditë për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv marginal prej 0.09, bazuar në përgjigjet e një banke me rëndësi sistematike. Pritjet për tremujorin aktual, të deklaruara nga bankat në anketën e kaluar (TM3 2023), rezultuan të ngjashme me vlerat aktuale (grafiku 4). Presioni nga konkurrenca dhe cilësia e mirë e portfolios kreditore ishin faktorët me ndikimin më të madh në lehtësimin e standardeve kreditore për ekonomitë familjare.

Në tremujorin e parë të vitit 2024, bankat presin ndryshime marginale pozitive në standardet kreditore; më e theksuar për kreditë për blerje të shtëpive, kurse për kreditë konsumuese lëvizje pozitive marginale. Faktorët që pritet të ndikojnë pozitivisht standardet kreditore janë perspektiva e bankave në tregun vendor, ecuria pozitive në tregun e patundshmërive si dhe rritja e besueshmërisë ndaj kredimarrësve. Bankat presin rritje të nivelit të aprovimit të kredive për ekonomitë familjare.

Konkretisht, pritet rritje e normës së aprovimit të kredive për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.04 dhe veçanërisht për kreditë konsumuese me indeks pozitiv prej 0.23.


Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht kishin lëvizje marginale negative në tremujorin e katërt të vitit 2023. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë shtrëngime marginale proporcionale si për kreditë për blerjen e shtëpive ashtu edhe ato konsumuese. Saktësisht, bankat aplikuan norma marginale më të larta të interesit për kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese me indeks negativ prej 0.03, rezultat i ndikuar nga përgjigjet e një banke (me rëndësi josistemike); përderisa bankat tjera deklaruan që normat e interesit ishin kryesisht të pandryshuara për të dy këto nënkategori të ekonomive familjare. Faktori kryesor në rritjen e normës së interesit (shtrëngim në kushtet dhe rregullat të aplikuara nga bankat) ishte rritja e normës së EURIBOR-it, normë e cila kryesisht aplikohet në kreditë me normë variable të interesit (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Për tremujorin e parë të vitit 2024, bankat në përgjithësi nuk presin lëvizje të rëndësishme të kushteve dhe rregullave për kredi për ekonomitë familjare. Për tremujorin e parë të vitit 2024, bankat në përgjithësi presin lëvizje të marginale pozitive në kushteve dhe rregullave për kreditë e ekonomive familjare, përfshirë rritjen e maturitetit të kredisë për blerje të shtëpive dhe ulje të kolateralit për kreditë me qëllim konsumi.


Kërkesa për kredi

Pas gjenerimit të rezultateve për kërkesën kreditore në këtë tremujor, rezulton që kërkesa kreditore nga ekonomitë familjare në përgjithësi ka shënuar rritje, mirëpo më të ulët në krahasim me tremujorin paraprak. Nëse e zbërthejmë kërkesën kreditore sipas llojeve të kredive për ekonomitë familjare, rezulton që kërkesa për kredi konsumuese shënoi rritje me indeks pozitiv prej 0.16, ndërsa kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive shënoi rritje me indeks pozitiv prej 0.09. Saktësisht, tri banka, prej tyre një me rëndësi sistemike, raportuan për rritje të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive, ndërsa një bankë tjetër (me rëndësi sistemike) raportoi për rënie të kërkesës për të njëjtat. Për kreditë konsumuese, katër banka, prej tyre dy me rëndësi sistemike, deklaruan rritje të kërkesës dhe një bankë (me rëndësi josistemike) raportoi rënie të kërkesës për të njëjtat. Nëse krahasojmë rezultatet e kërkesës aktuale për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtin periudhë, niveli aktual i rritjes së kërkesës është më i ulët (grafiku 6).

Nevoja për financim të shpenzimeve të konsumit dhe rritja e konfidencës së konsumatorëve kontribuuan në rritje të kërkesës për kreditë konsumuese. Kurse, perspektiva pozitive në tregun e patundshmërive ndikoi në rritje të kërkesës për kredi për blerje të patundshmërive. Njëkohësisht, cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare shënoi rritje pozitive marginale për kreditë për blerjen e shtëpive dhe për kreditë konsumuese, me indeks pozitiv prej 0.03 secila.

Bankat deklaruan përmirësim të cilësisë së portfolios kreditore për ekonomitë familjare, bazuar në indeksin negativ prej 0.03. Dinamikë e ndikuar nga përgjigjet e tre bankave, ku dy prej tyre me rëndësi josistemike, të cilat deklaruan rritje të raportit të kredive jo-performuese, kurse banka me rëndësi sistemike deklaroi rënie të raportit të kredive jo-performuese.

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Në tremujorin e parë të vitit 2024, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare pritet të ketë rritje të përafërt me tremujorin aktual. Konkretisht, bankat presin rritje të kërkesës për kredi konsumuese me indeks pozitiv prej 0.23 dhe për kredi për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.04. Pritjet për këtë dinamikë, u ndikuan nga përgjigjet e pesë bankave (dy prej tyre me rëndësi sistemike) të cilat presin rritje të kërkesës për kredi konsumuese dhe tri bankave (një prej tyre me rëndësi sistemike) të cilat presin rritje të kërkesës për kredi për blerje të shtëpive. Rezultatet e anketës sugjerojnë që kryesisht nevoja për të mbuluar shpenzimet e konsumit pritet ta nxis këtë rritje të kërkesës dhe në një nivel më të ulët perspektiva e mirë në tregun e patundshmërive. Bankat nuk presin ndryshime të rëndësishme në cilësinë e aplikacioneve të pranuar për kredi.

Gjatë TM1 2024, bankat presin që cilësia e portfolios kreditore e ekonomive familjare të përkeqësohet (por në nivel më të ulët se sa raportimi i bërë në tremujorin paraprak), bazuar në vlerën pozitive të indeksit. Saktësisht, pritjet e bankave për raportin e kredive jo-performuese rezultuan në indeks pozitiv 0.07, deklaruar nga dy banka, ku njëra nga to është banka me peshë të lartë në kreditim dhe me rëndësi sistemike.


Financimi

Bankat raportuan rritje të konsiderueshme të qasjes në financim edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, ngjashëm me raportimin në tremujorin paraprak. Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u bazua në përgjigjet e nëntë bankave (prej tyre pesë banka me rëndësi sistemike) të cilat deklaruan rritje të financimit.

Bazuar në rezultatin e agreguar të përgjigjeve, gjatë këtij tremujori gjithsej financimi shënoi rritje ngjashëm me nivelin e tremujorin e kaluar dhe pothuajse dyfish me TM2 2023, saktësisht indeks pozitiv 0.59 (indeks pozitiv 0.57 në TM3 2023 dhe 0.28 në TM2 2023). Ngjashëm, depozitat e ekonomive familjare gjeneruan një indeks pozitiv prej 0.64 (0.63 në TM3 2023), pothuajse dyfish më i lartë krahasuar me TM2 2023 (indeks pozitiv 0.35). Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e nëntë bankave pjesëmarrëse në anketë, ku prej tyre pesë janë banka me rëndësi sistemike; për më tepër, dy nga këto banka deklaruan rritje të konsiderueshme të depozitave nga ekonomitë familjare. Për dallim nga tremujori paraprak, financimi nga depozitat e ndërmarrjeve edhe pse shënoi rritje, ishte dukshëm në nivel më të ulët; me indeks pozitiv 0.29 (indeks pozitiv 0.58 në TM3 2023 dhe 0.03 në TM2 2023), duke reflektuar përgjigjet e gjashtë bankave pjesëmarrëse, ku prej tyre tri janë banka me rëndësi sistemike. Financimi nga bankat amë dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare mbetën kryesisht të pandryshuara (grafiku 7). Sa i përket maturitetit të financimit, në këtë tremujor rritje më të lartë kishte për maturitetet afatshkurtra. Konkretisht, depozitat afatshkurtra gjeneruan indeks pozitiv prej 0.39, ndërsa ato afatgjata gjeneruan indeks pozitiv prej 0.15.

Për tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje të gjithsej qasjes në financim, por në nivel dukshëm më të ulët se me tremujorin aktual me indeks pozitiv prej 0.17, e deklaruar nga shtatë banka pjesëmarrëse në anketë. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar me indeks pozitiv prej 0.27, pasuar nga financimi nga depozitat e ndërmarrjeve me indeks pozitiv prej 0.17, deklaruar nga gjashtë banka të cilat presin rritje të këtyre burimeve të financimit. Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin që rritja e financimit të burojë nga maturitetet afatgjata. Konkretisht, pritet rritje e financimit afatgjatë me indeks pozitiv 0.27, përderisa rënie marginale nga financim afatshkurtër, me indeks negativ 0.03 (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Burimi: BQK.

* Vlera e pritur

Rezultatet e pyetjeve të fokusuara

Pyetësi i anketës për tremujorin e katërt të vitit 2023 është plotësuar me katër pyetje shtesë në përpjekje për të identifikuar rreziqet eminente në sektorin bankar, si dhe zbërthimin e ofertës dhe kërkesës kreditore sipas sektorëve ekonomik.

Pyetësi i anketës së realizuar në TM4 2023 ka për qëllim matjen e sentimentit të bankave rreth zhvillimeve kryesore dhe sfidave të sektorit financiar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024. Efekti potencial i liberalizimit të vizave, politikat bankare rreth tregut të patundshmërive, si dhe ekspozimi/menaxhimi i likuiditetit në gjashtë muajt e parë të vitit 2024 ishin disa nga pyetjet shtesë që BQK ka parashtruar ndaj bankave. Në përgjigjet e tyre, në përgjithësi, bankat deklaruan se nuk presin ndonjë ndryshim të theksuar në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare, ndërlidhur me efektin e liberalizimit të vizave. Sa i përket sektorit të patundshmërisë, politikat e bankave në përgjithësi pritet të jenë më të favorshme, ndërkohë që kërkesa për kredi për këtë segment pritet të rritet deri në një masë - në linjë me zhvillimet makroekonomike në vend. Sa i përket likuiditetit, bankat në përgjithësi kanë deklaruar për qasje të kujdesshme për menaxhim të likuiditetit, dhe qëndrimet konsistojnë në sigurinë se nuk presin vështirësi përgjatë gjashtë muajve në vijim.

Përgjigjet e disagreguara të bankave për ndërmarrjet, sipas sektorëve, tregojnë për kahjen e financimit të ekonomisë dhe dinamikat në sektorë të caktuar. Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, standardet kreditore kishin ndryshime margjinale të papërfillshme në të gjithë sektorët ekonomik. Rezultat marginal negativ, që nënkupton shtrëngim të standardeve kreditore, kishte për sektorin e ndërtimtarisë me indeks negativ 0.02. Kurse, për sektorin e prodhimit, tregtisë dhe shërbimeve indeksi negativ ishte 0.01. Kushtet dhe rregullat u shtrënguan në masë më të madhe për sektorin e ndërtimtarisë, ndërsa u lehtësuan deri në një masë për sektorin e prodhimit dhe atë të tregtisë. Për sektorin e patundshmërive, kushtet dhe rregullat rezultojnë të jenë shtrënguar deri në një masë, ndikuar nga zhvillimet në patundshmëritë komerciale, pasi që ato rezidenciale kishin lehtësim deri në një masë. Në anën tjetër, kërkesa për kredi shënoi rritje gjatë kësaj periudhe. Sektori me kërkesën më të rritur për financim ishte ai i tregtisë, me indeks pozitiv 0.22, rritje e deklaruar nga pesë banka. Njëkohësisht, sektori i dytë me kërkesë të rritur ishte sektori i ndërtimtarisë me indeks pozitiv prej 0.09, rritje e deklaruar nga tri banka.

Bazuar në rezultatet e gjeneruara, gjatë tremujorit të ardhshëm bankat pritet të aplikojnë ndryshime të vogla në ofertën kreditore (shtrëngime margjinale) për të gjithë sektorët ekonomik të përfshirë në anketë. Kushtet dhe rregullat pritet poashtu të kenë shtrëngime margjinale. Në të njëjtën periudhë, kërkesa për kredi pritet të ketë lëvizje pozitive. Konkretisht, pritet rritje e kërkesës nga sektori i tregtisë dhe prodhimit (indeks pozitiv 0.13 dhe 0.10, respektivisht).

Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK anketon institucionet financiare në vend. Kjo ndodhë duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKBK është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet e çmimeve në vend. Kjo ndihmon në plotësimin e publikimeve tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit, përveç deklarimit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin e kaluar, pyetësori adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e parë të vitit 2024 si dhe për vitin 2024 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ato ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet që kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit.

Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se ato shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë në kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë, ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore, shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht vlerësimet për tremujorin aktual si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm dhe vitin aktual në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

Përmbledhja e rezultateve

Në bazë të anketës së kryer në janar të vitit 2024, bankat kanë vlerësuar nivelin e inflacionit në tremujorin e parë të vitit 2024 të ngjashëm me atë të tremujorit paraprak, ndërsa për gjithë vitin 2024, deklaruan se presin që niveli i inflacionit të jetë 3.5 përqind, në krahasim me 4.9 përqind në vitin 2023.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje


Bankat	TM4 2023	TM1 2024	2024
1	4.3%	3.9%	3.5%
2	2.3%	2.2%	2.0%
3	4.2%	2.6%	5.2%
4	3.4%	3.3%	3.2%
5	2.3%	3.5%	3.5%
6	4.2%	3.7%	3.8%
7	3.1%	3.9%	3.9%
8	2.3%	3.7%	2.7%
9	3.3%	3.4%	3.3%
10	4.9%	4.0%	4.5%
Mesatarja	3.4%	3.4%	3.5%

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.

Figura 8 ilustron shpërndarjet e raportuara të probabilitetit, duke treguar një siguri relativisht të lartë në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit. Kjo pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë përmendur disa faktorë kyç që kanë ndikuar dhe pritjet të ndikojnë në shkallën e inflacionit, duke përfshirë rritjen e normave të interesit nga Rezerva Federale në SHBA, Banka Qendrore Evropiane, dhe Banka e Anglisë. Rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, së bashku me ngadalësimin e rritjes së ekonomisë globale, mund të kenë ndikuar në ngadalësimin e rritjes së inflacionit, duke marrë parasysh varësinë e madhe të ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave, etj.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM1 2024 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.

Përveç kësaj, faktorë të tjerë që kanë ndikuar që inflacioni të mbetet ende i lartë përfshijnë luftën në Ukrainë, me ndikim të rëndësishëm nga Rusia dhe Ukraina si furnizues të lëndëve të para, lufta në Gaza, si dhe presionet e brendshme për rritjen e pagave.

Si përfundim, bankat presin që të ketë një ngadalësim të rritjes së inflacionit gjatë vitit 2024. Gjithashtu, edhe të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për dy muajt e parë të vitit 2024 tregojnë për një ngadalësim edhe më të theksuar të normës së inflacionit (norma mesatare 2.0 përqind). Megjithatë, pritjet për ngadalësim mund të ndikohen negativisht nga zhvillimet globale dhe pasiguria rreth tyre.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org